



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

Raporti i Universitetit të Gjirokastrës
Maj 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|--------------------------|---------|
| 1 | Dr. Heather Barrett-Mold | Kryetar |
| 2 | Profesor Sherif Bundo | Anëtar |
| 3 | Profesor Ed Esche | Anëtar |
| 4 | Dr. David Taylor | Anëtar |

Datë: 11-12 maj 2017

Përmbajta

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	14
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	19
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	22
Lista e Dokumenteve	27

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Gjithashtu, ky raport, i ndihmon IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës u hap më 12 nëntor të vitit 1991, duke përforcuar punën e Institutit Pedagogjik, i cili ishte themeluar që në vitin 1971. Universiteti i Gjirokastrës ndodhet në Rajonin Jugor të Shqipërisë. Më parë, në këtë rajon, arsimi i lartë ofrohej nga universitete të tjera shqiptare. Gjatë vitit akademik 1993-1994, Universiteti i Gjirokastrës u zgjerua më tej, duke ofruar dy programe të reja studimi, përkatësisht atë të Gjuhës dhe Letërsisë Greke, për përgatitjen e mësuesve për shkollat e pakicës greke, dhe të Gjuhës Angleze.

Aktualisht, universiteti ka tre fakultete: Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, si dhe Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, që ndahen në 14 departamente. Misioni i universitetit përqendrohet në:

- Përgatitjen e mësuesve të të gjitha niveleve të sistemit arsimor parauniversitar
- Përgatitjen e infermierëve të përgjithshëm dhe mamive
- Përgatitjen e specialistëve në fushën e ekonomisë
- Përgatitjen e specialistëve të teknologjisë së informacionit
- Funksionimin si një qendër e rëndësishme për veprimtarinë kërkimore, shkencore dhe botuese në Rajonin Jugor.

Universiteti ofron tre cikle studimi: Bachelor, Master dhe një Doktoraturë, të miratuar, në Albanologji. Të gjitha programet e studimit dhe kurrikulat e tyre rristrukturohen në përputhje me kërkesat e Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit aktual. Universiteti bashkëpunon dhe ka krijuar partneritete me universitetet e vendeve të tjera.

Raport i përmbledhur

Universiteti i Gjirokastrës është një institucion publik i arsimit të lartë, që ndodhet në qytetin e Gjirokastrës, që është një prej vendeve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, vetëm 49 km larg kufirit me Greqinë. Rëndësia e trashëgimisë dhe afërsia me Greqinë, ndikojnë që të dyja në punën e universitetit. Universiteti ka krijuar partneritete dhe punon ngushtësisht me universitete të tjera në rajon, duke promovuar përparësitë rajonale. Si shembull mund të merret bashkëpunimi i ngushtë me Universitetin e Janinës në Greqi, për të sjellë përfitime jo vetëm të ndërsjella për të dyja palët, por edhe për pakicën greke që jeton në Shqipëri. Kjo gjë, si dhe përfshirja në listën e UNESCO-s e kanë përforcuar më tej punën e rëndësishme që po kryhet në fushën e trashëgimisë kulturore, ku universiteti luan rol qendror. Hapja e dyerve të bibliotekës së specializuar në qytetërimin ballkanik të këtij universiteti për komunitetin vendas, është vetëm një prej aspekteve të kësaj pune.

Gjatë kohës së kryerjes së vizitës, numri i studentëve të regjistruar ishte 1,627. Pavarësisht faktit se shumica prej tyre vijnë nga Shqipëria Jugore, kontigjenti i studentëve që vijnë nga Shqipëria e Mesme dhe Shqipëria Veriore është i konsiderueshëm. Gjatë vitit akademik 2016-2017, për veprimtarinë kërkimore shkencore dhe në mësimdhënie, dhanë kontribut rreth 124 pedagogë me kohë të plotë dhe 80 lektorë të ftuar, ndërsa 70 për qind e stafit akademik u kualifikuan me tituj akademikë dhe grada shkencore në doktoraturë. Universiteti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u përgatit nga grupi i ngritur nga universiteti, që përbëhej edhe nga një përfaqësues i trupës studentore. Ky raport ndihmoi në përcaktimin e proceseve dhe procedurave që do të ndërmerren, si dhe të ofertës së programeve. Ai bazohej kryesisht te dokumentet e bashkëlidhura, pjesa më e madhe e të cilave ishin në gjuhën shqipe, duke vështirësuar interpretimin e tyre nga ekspertët anglezë. Niveli i vetëvlerësimit nuk i përbushi pritshmëritë. Për më tepër, projektraportet u shpërndanë një audience më të gjerë brenda institucionit përpara përfundimit dhe miratimit nga Rektori.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve, në datat 11 dhe 12 prill të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. U shqyrtuan 217 dokumente gjithsej, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njëjti me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Këto dokumente përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, shembujt e informimit rreth programeve, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerë të jashtëm dhe punëdhënës. Diskutimi mbështetej në sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, hapësirat e mësimdhënies, laboratorët, dhe zyrat.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e mëposhtme: Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë përmbushur kryesisht. Universiteti drejtohet me efikasitet. Organet e brendshme drejtuese janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Bordi i Profesorëve, Këshillat e Fakulteteve dhe Këshillat e Departamenteve. Universiteti ka një sërë mekanizmesh që sigurojnë funksionimin dhe monitorimin efikas të universitetit brenda kufijve të autonomisë së tij, duke përfshirë edhe funksionet drejtuese të Zëvendës Rektorit dhe Zëvendës Dekanëve, si dhe procedurat e sigurimit të cilësisë të përcaktuara në statut, si p.sh. veprimtaria e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe komisionit të posaçëm për cilësinë e brendshme, i ngritur enkas nga Rektori për vlerësimin e jashtëm. Universiteti bashkëpunon me efikasitet me partnerët në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai përpiqet ta monitorojë punësimin e të diplomuarve përmes bazës së të dhënave në shkallë departamenti, por faktet për mbledhjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të të dhënave janë të pakta.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Universiteti ka hartuar politika për burimet njerëzore, që mbështesin integrimin e stafit akademik dhe joakademik, ku një prej prioriteteve është barazia. Universiteti ndjek një proces të hapur dhe konkurrues për të gjithë emërimet. Përdorimi i teknologjive të reja nuk është përkthyer ende në përfshirjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në teknikat e mësimdhënies, duke kufizuar larminë e qasjeve kundrejt mësimdhënies. Universiteti përdor tre godina dhe ka rënë në ujdi me organizata të tjera për përdorimin e ambienteve të tjera, por ndërkohë, po planifikon të përdorë edhe një tjetër.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht. Universiteti ka zhvilluar një sërë programesh të ciklit të parë dhe të dytë në arsimin parësor dhe 9 vjeçar, si dhe të ciklit të parë në infermieri. Universiteti e ka identifikuar formimin e mësuesve si prioritet. Ai ka hartuar programe të ciklit të parë për Gjuhën dhe Letërsinë Greke për përgatitjen e mësuesve në shërbim të nevojave të pakicës greke në rajon. Hartimi i programeve, ku nevojat rajonale përfshihen në misionin e tretë të universitetit, është i mirë. Efikasiteti i shpërndarjes së informacionit konsiderohet si karakteristikë e praktikës së mirë. Studentët angazhohen në mënyrë aktive nëpër projekte kërkimore. Mentorimi në vazhdim i mësuesve të rinj është tejet i vlefshëm, por mund të sjellë përforsimin e metodave tradicionale të mësimdhënies.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Universiteti organizon me efikasitet zbatimin e programeve të tij të studimit. Në fund të çdo viti akademik, kryhen kontrolle në shkallë departamenti, në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit. Kërkimi lidhur me zhvillimin rajonal dhe ruajtjen e kulturës është një prej drejtimeve më të rëndësishme të veprimtarisë së universitetit, siç identifikohet në aktet dhe dokumentet e tij kryesore. Nevojitet një strategji specifike për kërkimin, pasi niveli i tij është i pamjaftueshëm.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht. Komunikimi me studentët është efikas. Universiteti mbështet edhe studentët e ciklit të parë. Gjatë orientimit, që monitorohet nga Zëvendës Rektori, stafi akademik i departamenteve i prezanton studentët me ato çka duhet të dinë me saktësi rreth universitetit dhe programeve të tyre. Gjithashtu, stafi akademik ofron udhëzime për përgatitjen e tezave, procedura të qarta për detyrat e kursit, si dhe udhëzime për literaturën e leksioneve dhe departamentit. Universiteti i nxit studentët të marrin pjesë në jetën universitare. Në janar të çdo viti akademik, zgjidhen edhe përfaqësuesit e studentëve secili çdo vit dhe disiplinë për Këshillin Studentor. Pas kësaj faze, ata zgjedhin tre senatorët e studentëve, duke përfshirë edhe Kryetarin e Këshillit Studentor. Këshilli Studentor është një kanal komunikimi dydrejtimësh për studentët, përmes të cilit universiteti mund t'i përcjellë informacion organeve studentore, si dhe të mbledhë dhe t'i përgjigjet feedback-ut tejet të vlefshëm të studentëve.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet e universitetit me partnerët rajonale janë të shkëlqyera (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.2**)
- hartimi i programeve, ku nevojat rajonale përfshihen në misionin e tretë të universitetit (pika 3.1; **Kapitulli I Standardi I.1**; **Kapitulli 1 Standardi I.3**)
- shpërndarja efikase e informacionit, që po siguron mirinformimin e audiencës së synuar (pika 3.4; **Kapitulli I Standardi I.1**)
- angazhimi i studentëve në mënyrë aktive në një sërë fushash si në ciklin e parë, ashtu edhe në ciklin e dytë në projektet kërkimore të Departamentit të Gjeografisë dhe Matematikë Fizikës (pika 3.13; **Kapitulli I Standardi I.9**)
- puna bashkëpunuese në veprimtarinë kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.6**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e mbledhjes sistematike e të dhënave të të diplomuarve të punësuar (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.2**)
- mungesa e teknologjisë së informacionit të teknologjisë, që kufizon larminë e qasjeve kundrejt mësimdhënies (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.2**)
- mungesa e qasjes strategjike për mbështetjen e kërkimit (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.5**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- ngritja dhe vënia në punë e një sistemi për mundësimin e analizimit të të dhënave të punësimit të të diplomuarve, që do të shërbejë për hartimin dhe përgatitjen e programit (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.2**)
- marrja e masave për përfshirjen e teknologjisë së informacionit gjatë ofrimit të programeve të tij (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.2**)
- përgatitja e një strategjie institucionale, ku të identifikohen dhe mbështeten prioritetet (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.5**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**.

Gjykimi i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Tiranës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i Tij

- 1.1 Kuadrot drejtuese dhe rregullatore të Universitetit të Gjirokastrës janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe të përafuar me misionin dhe objektivat e tij. Si institucion publik i arsimit të lartë, universiteti e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ndryshimet e tij, Nenin 91 të Statutit të brendshëm ligjor dhe me Nenin 78 të Rregullores së tij. **[RVV fq.9; 1.1; 1.2]** Universiteti ka edhe rregulloret e tjera të brendshme në shkallë fakulteti. **[RVV fq. 9; 1.9]** Ai përshtat dhe përmirëson vazhdimisht statutin dhe rregulloret për përmirësimin e cilësinë së shërbimit. Për shembull, disa prej ndryshimeve rishtas lidheshin me punësimin e stafit akademik dhe funksionimin e sistemit ESSE3. **[RVV fq.9, 1.3; 1.4; M11]** Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 07.09. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, universiteti ka hartuar dhe miratuar tashmë Statutin dhe Rregulloren e re për t’iu përmbajtur ligjit të ri gjatë zbatimit. **[RVV fq.9; 1.1a; 1.2a] [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Universiteti drejtohet me efikasitet. Organet e brendshme drejtuese janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Bordi i Profesorëve, Këshillat e Fakulteteve dhe Këshillat e Departamenteve **[RVV fq.9-10; 1.2, Nenet 10, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19; 1.8; 1.10; M1;M3;M4; M11;M12;M15]**
- 1.3 Autoritetet drejtuese të universitetit janë: Rektori dhe Zëvendës Rektori, Dekanët dhe Zëvendës Dekanët e fakultetit, si dhe Mbikëqyrësit dhe Përgjegjësit e Departamenteve. **[RVV fq.11; 1.2, Nenet 22, 23, 28, 29; M1; M4; M11]** Pas marrjes së kërkesës nga zyrat dhe departamentet e universitetit, Rektorati harton dhe propozon buxhetin, të cilin ia paraqet Senatit Akademik për diskutim dhe miratim. Më pas, projektbuxheti i dërgohet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar dhe i dorëzohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq.9; 1.2, Nenet 12.7c; 13.2c, 13.2.e, 14.4.b; 1.5; B.6; B.7; B.8; M1; M3] [Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.4 Universiteti ka dy fakultete, ku secili ka rregullore të veçanta, dhe është në prag të hapjes së një tjetri **[RVV fq.10; 1.2 Nenet 16; 1.9; C11]** të cilët, së bashku me departamentet e tyre do të veprojnë sipas frymës së lirisë akademike. **[1.1 Neni 4]** Këshilli i Fakultetit është një organ vendimmarrës kolegjal, përfaqësuesit e të cilit zgjidhen nga stafi akademik i fakultetit, dhe drejtohet nga Dekani. Ai merr vendime për çështje që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, të cilat propozohen zakonisht nga departamentet. **[1.2 Neni 16; 1.9 Neni 8, 3.a dhe b; M4]** Universiteti ka ngritur Këshillin e Profesorëve me vendim të Senatit Akademik, qëllimi i të cilit është administrimi i studimeve të doktoraturës, studimeve të pas doktoraturës, kualifikimeve shkencore dhe pedagogjike, si dhe i formimit të personelit. **[RVV fq.10; 1.2 Neni 16, fq.18-19; 1.10]** Këshilli i Profesorëve nuk funksionon, pasi pranë njërive kryesore nuk është punësuar numri i nevojshëm i profesorëve me kohë të plotë. Kjo gjë nuk ka asnjë ndikim, pasi aktualisht, nuk ka asnjë student të ciklit të tretë. **[RVV fq.9-11; M2][Kapitulli II;Kapitulli I.2 Standardi II.3]**
- 1.5 Rektorati dhe Bordi i Administrimit organizojnë mbledhje në mënyrë periodike dhe konstruktive, ku diskutojnë për çështje me rëndësi për universitetin, ku përfshihen buxheti, Strategjia e Zhvillimit, dhe Raporti Vjetor, si dhe për çështje më vendore, si p.sh hartimi i kurrikulës dhe përditësimi i teknologjisë së informacionit. **[1.14; C.1; 1.15; C.2; M1;M3;M12;M13]** Të gjitha organet kolegjiale funksionojnë në të njëjtën mënyrë, dhe mbledhen një herë në muaj përgjatë gjithë vitit akademik. **[RVV fq.11; 1.2 Neni 11]** Të gjithë anëtarëve si p.sh të Këshillit të Fakultetit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit iu vunë në dispozicion të gjitha materialet për shqyrtim dhe diskutim të paktën një ditë pune përpara mbledhjes. **[RVV fq.11; 1.2 Neni 11, 2]** Afati prej vetëm një dite është shumë i shkurtër për shqyrtimin e materialeve të mbledhjeve të rëndësishme, dhe si rrjedhojë, koha e komunikimit ndërmjet anëtarëve të komisioneve për shkëmbimin e pikëpamjeve mund të jetë e pamjaftueshme. Megjithatë ndërmerren disa veprime, mbledhjet nuk bazohen në plane veprimi, të cilat do të ishin specifike dhe do t’iu shpërndaheshin disa personave të caktuar,

gjë që do të ndihmonte në lehtësimin e ndarjes dhe ndjekjen e vendimeve në shkallë universiteti. **[M4] [Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3]**

- 1.6 Universiteti ka një sërë mekanizmash të brendshëm, që sigurojnë funksionimin dhe monitorimin efikas pa kaluar kufijtë e autonomisë. Këtu përfshihen funksionet drejtuese të Zëvendës Rektorëve dhe Zëvendës Dekanëve dhe procedurat e sigurimit të cilësisë të përcaktuara në Statut si p.sh funksionimi i Njësisë së Brendshme për Sigurimin e Cilësisë dhe i Komisionit për Sigurinë e Brendshme, i ngritur nga Rektori enkas për vlerësimin e jashtëm. **[RVV fq.11; 1.12; 1.2 Nenet 67-72]** Çdo vit, universiteti publikon një përmbledhje të shkurtër të punës së Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në faqen e tij të internetit. [\[www.uogj.edu.al\]](http://www.uogj.edu.al) (si në 03/04/17 dhe 22/05/17); **1.2 Neni 72; C.10]** Zëvendës Rektori për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, si dhe Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor i japin mundësinë universitetit të përfitojë nga programet evropiane edhe ndërkombëtare, si p.sh nga projekti Tempus U3M, dhe të aplikojë për të tjera si p.sh për Erasmus+ dhe Horizon 2020. Universiteti e pranon se ka nevojë të vijojë të përgatisë projekte për mbështetjen e misionit dhe financave **[RVV fq.12; 1.13; M2; M4; C.9] [Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.7 Universiteti ndjek një Strategji Zhvillimi efikase, ku përcaktohet qartësisht misioni dhe renditen rreth nëntë objektiva për arritjen e tij. Këto të fundit përfshijnë përditësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për të përballuar kërkesën, si dhe hartimin e programeve apo projekteve të reja. **[RVV, fq.12; 1.14; C.1 p.8-9]** Strategjia hartohet nga Rektori, pas një diskutimi të hapur me organet dhe autoritetet drejtuese. Ajo përqendrohet në zhvillimin rajonal **[1.2 Neni 13, 2.a; M3; M8; M13]** dhe trajton përmirësimin e infrastrukturës, rekrutimin e stafit të ri akademik, mësimdhënien dhe mësimnxënien, kërkimin dhe studimet shkencore, si dhe financat dhe burimet financiare. **[1.14 fq.13-25]** Strategjia është e hapur dhe e drejtpërdrejtë rreth vështirësive që has universiteti dhe rrugëve që duhen ndjekur për t'i kapërcyer ato. Së fundi, ajo përmbyllet me një analizë të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, që më tepër se një plan veprimi, është një përmbledhje me titullin "Rreth situatës së UGJ-së" **[1.14 fq.27-29] [Kapitulli III Standardi I.5]**
- 1.8 Rektori përgatit Raportin Vjetor të Universitetit dhe ia paraqet Senatit Akademik për miratim, përpara se t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe përpara publikimit në faqen e internetit të universitetit. **[RVV fq.12; 1.2 Nenet 13.4, 12.7.k; 1.15; C.2; M1]** Të gjitha njësitë e universitetit përgatisin raporte, që shërbejnë si bazë për Raportin e përgjithshëm Vjetor. Për shembull, departamentet përgatisin raportet përkatëse, ku mbështetet Raporti Fakultetit, që i dërgohet Rektorit. **[1.6; M11]** Raporti Vjetor përveç veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, si dhe objektivat dhe detyrat për veprimtarinë e ardhshme dhe financiare. **[1.15; C.2; M1][Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.9 Universiteti ka strukturat e duhura për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të tillë që të respektojë parimet e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike, të shprehura në Statut dhe Rregullore. **[RVV fq.13; 1.1 Nenet 3-9; 1.2 Nenet 3, 7-8, 49-51]** Organogramat e strukturave drejtuese dhe strukturës së njërit prej fakulteteve, të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ndihmojnë në ilustrimin e strukturës së universitetit. **[1.17; 1.18; C.11]** Në dy fakultetet e ndara në 12 departamente, universiteti ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master Profesional, Master i Shkencave, dhe Doktoraturë **[RVV fq.13; 1.1 Nenet 16, 17; 1.2 Neni 34 [1.1 Neni 4]**, dhe aktualisht po planifikon të hapë edhe Fakultetin e tretë, Fakultetin e Ekonomisë. **[RVV fq.13; 1.1a Neni 8]** Ai ka edhe faqen e tij të internetit (shihni edhe pikën 1.6). **[Kapitulli III, Standardi II.1]**
- 1.10 Rruga kryesore që ndjek universiteti për t'u përditësuar me zhvillimet ekonomike, sociale dhe arsimore është përmes komunikimit me rrjetet e gjera rajonale (shihni pikën 1.11). Ai përpiket ta monitorojë punësimin e të diplomuarve përmes bazës së të dhënave në shkallë departamenti, por ka shumë pak fakte për mbledhjen e vazhdueshme ose të qëndrueshme të të dhënave në rang departamenti ose universiteti për t'i dhënë tërësisë së këtyre të dhënave karakter më informues. Universiteti e pranon se informacioni ishte i paplotë. **[RVV fq.15; M4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e mbledhjes sistematike të të dhënave për punësimin e të diplomuarve si **dobësi**, dhe i rekomandon universitetit ngritjen dhe

vënien në punë të një sistemi për të mundësuar analizimin e të dhënave të punësimit të të diplomuarve, që do të shërbejë si bazë për hartimin dhe përgatitjen e programeve. **[Kapitulli III, Standardi III.2]**

- 1.11 Strategjia e bashkëpunimit e universitetit është pjesë e Strategjisë së tij të Zhvillimit dhe përmendet qartësisht në misionin e tij. **[1.15; C.2]** Veprimtaritë e tij bashkëpunuese me institucionet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare administrohen nga Dega e Marrëdhënieve me Jashtë. Në shkallë rajonale, ai bashkëpunon kryesisht me shkollat dhe spitalet me të cilat ka lidhur marrëveshje. **[M4]** Afërsisht 300 nga 400 mësues, që punojnë në këtë Gjirokastrë, dhe 82 për qind e infermierëve të spitalit rekrutohen nga universiteti. Përfaqësuesit e të dy sektorëve të punësimit shprehen tejet të kënaqur me të diplomuarit e punësuar. **[M8]** Edhe politikanët vendas, përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Drejtori i zyrës së Punësimit vlerësojnë pozitivisht mënyrën se si të diplomuarit e universitetit përmbushnin nevojat e tyre. **[M8]** Hartimi i programit të ri “Bachelor në Turizëm” erdhi si pasojë e kërkesës së tregut të punës, bazuar në kërkimin e dy projekteve SEE JEWEL dhe Tempus U3M; i programit “Bachelor në Administrim Publik”, për shkak të rolit të rëndësishëm që luan Gjirokastra si qendër administrative; dhe i programit “Bachelor në Matematikë dhe Informatikë”, si rrjedhojë e nevojave rajonale të tregut të punës. Bashkëpunimet e universitetit me partnerët rajonalë, që mbështesin dhe mundësojnë hartimin e kurrikulave novatore, të cilat përmbushin nevojat rajonale, janë të shkëlqyera dhe konsiderohet si karakteristikë e **praktikës së mirë**. Bashkëpunëtorët në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare përfshijnë projektin e suksesshëm Tempus U3M me Universitetin e Tiranës dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike, Universitetin e Palermos dhe Universitetin e Janinës. **[RVV fq.15-16; 2.20; 1.20; B.12; C.12; C.7; C.9; M3; M8] [Kapitulli III Standardi III.2]**
- 1.12 Për të mbështetur ofrimin e programeve, universiteti ndjek strategjinë e bashkëpunimit me institucione të tjera. Ai bashkëpunon me Drejtorinë Arsimore Rajonale të Gjirokastrës, drejtoritë e tjera dhe qendrat spitalore për t'i vendosur studentët e tij në praktika profesionale **[RVV fq.16; M8]** dhe me SHA 'Studenti' për t'i akomoduar. Së brendshmi, ai bashkëpunon me Departamentin e Historisë, si dhe me Departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek për t'i ofruar studentëve veprimtari kulturore dhe artistike; ndërsa së jashtmi, me Korpusin e Paqes për ofrimin e mësuesve vullnetarë dhe konsullatat italiane dhe greke në Gjirokastrë për të ndihmuar në mësimdhënien e gjuhëve. **[RVV fq.10; 1,19; 1,20][Kapitulli III Standardi III.3]**
- 1.13 Universiteti ofron mobilitet modest për stafin akademik dhe studentët përmes marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare me universitetet e tjera, angazhimit në programe ndërkombëtare si Erasmus + dhe Tempus, dhe pjesëmarrjes së personelit në konferenca ndërkombëtare. Stafi akademik ka paraqitur punime dhe ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, por financimi i këtyre të fundit është ndërprerë për shkak të shkurtimit të buxhetit. **[4.8; M2; M14]** Akademikët e huaj integrohen përmes projekteve bashkëpunuese me universitete të tjera si p.sh me universitetin e Maceratës në projektin e trashëgimisë kulturore, si dhe me studentë të huaj, si p.sh me dy studentë polakë në fushën e etnografisë. **[M3]** Aktualisht, pesë anëtarë të stafit të Fakultetit Ekonomik janë përfshirë në një shkëmbim me Universitetin e Galicisë. **[M11]** Në katër vjet, universiteti ka organizuar tre konferenca ndërkombëtare shkencore, **[4.7]** si dhe ka lidhur marrëveshje me 48 partnerë për të mundësuar shkëmbimin e studentëve, por jo të gjithë janë institucione ndërkombëtare. **[1,20] [Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet e universitetit me partnerët rajonalë janë të shkëlqyera (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.2**).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e mbledhjes sistematike e të dhënave të të diplomuarve të punësuar (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.2**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- ngritja dhe vënia në punë e një sistemi për mundësimin e analizimit të punësimit të të diplomuarve, që do të shërbejë për hartimin dhe përgatitjen e programit (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.2**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Organograma që është publikuar në faqen e internetit, është shumë e qartë **[2.1]**. Universiteti ndjek një politikë për rekrutimin e stafit akademik, duke i dhënë përparësi anëtarëve të kualifikuar, që përmbushin nevojat e departamentit. Kriteret e punësimit për stafin akademik me kohë të plotë, kohë të pjesshme dhe të ftuar, janë në përputhje me kërkesat ligjore. **[M4]** Janë theksuar nevojat e studentëve. **[M4]** Vendet e punës shpallen në faqen e internetit dhe në mediat vendase, ndërsa kriteret e tyre publikohen. **[2.3]** Për rekrutimin dhe aplikimet me pikëzim vihen në zbatim udhëzimet e brendshme. **[1.3]** Përparësi i jepet rekrutimit të stafit akademik të kualifikuar në universitetet e spikatura të botës. **[M3; M11; 2.5, Pyetësi i Personelit]** Studentët vunë në dukje angazhimin e pedagogëve dhe gatishmërinë e personelit në ofrimin e mbështetjes shtesë jashtë klase. **[Pyetësi i Studentëve 90% mirë ose shumë mirë; M5] [Kapitulli II Standardi IV.1]**
- 2.2 Universiteti ka miratuar politika për burimet njerëzore, që mbështesin integrimin e stafit akademik dhe personelit joakademik, ku një prej prioriteteve është barazia. **[M4]** Universiteti ndjek një proces të hapur, konkurrues dhe objektiv për të gjitha emërimet. Nevoja për personel identifikohet nga departamenti, dhe më pas, ky informacion i përcillet Dekanit, i cili miraton kërkesat e departamenteve dhe më pas, ia dërgon këto kërkesa Rektorit. Ky i fundit sigurohet që kërkesat të jenë në përputhje me legjislacionin. Për shqyrtimin e aplikimeve ngrihet një komision i posaçëm nga fakulteti përkatës, dhe më pas, fillon faza e intervistave. Fituesi miratohet formalisht nga Rektori në përputhje me legjislacionin. **[1.3; B.5; M4]** Shumica e personelit të universitetit janë të kualifikuar me doktoraturë. **[M4, 70%]** Të gjithë punonjësit e universitetit kanë sigurime shëndetësore, pasi i paguajnë kontributet e sigurimit të detyruar shëndetësor, në përputhje me legjislacionin përkatës. **[1,3; B.5; M4][Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Dita e Informimit është një ditë e rëndësishme për universitetin, ku përfshihet i gjithë personeli, dhe përfaqëson veprimtarinë kryesore të informimit të studentëve të mundshëm rreth universitetit. Kjo veprimtari, mbështetet nga informacioni i ofruar përmes fletëpalosjeve, faqes së internetit, posterave, radios dhe televizionit vendas, si dhe barkodeve dy dimensionale. Këto të fundit, vendosen në afërsi të godinës, në mënyrë që studentët të mund të kenë gjithmonë akses në informacionet përkatëse. Në qendër të vëmendjes vihen kryesisht maturanët. Gjithashtu, personeli merr pjesë edhe në panairin e Ministrisë së Arsimit, dhe viziton të gjitha shkollat e rajonit për të siguruar mirinformimin e të gjithëve rreth universitetit dhe programeve të tij. **[M2; M5] [Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.4 Krahas përfshirjes në projekte specifike me të tjerë, universiteti planifikon zakonisht edhe ofrimin e formimit për t'i mbështetur ato. Për shembull, projekti i sistemit online të të dhënave të studentëve kërkonte formim të veçantë. Përditësimi vjetor i jetëshkrimeve të personelit i jep mundësinë Dekanit të çdo fakulteti të analizojë arritjet në vazhdim të personelit. **[2.7; 2.8]** Këshilli Studentor është i pavarur dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programeve. Për shembull, studentët vunë në dukje se mbajtja e shënimeve të gjata me dorë në klasë nuk ishte aspak e dobishme dhe së bashku me anëtarët e personelit zgjodhën mënyrën më të mirë për të përparuar në këtë drejtim. **[M1; M5]** Nëse personeli, pas analizimit të rezultateve të pyetësorëve të studentëve, vë re ndonjë dobësi, e trajton këtë të fundit në bashkëpunim me një profesor nga e njëjta fushë. **[M2; M3]** Universiteti organizon leksione të hapura, ku pjesëmarrësit i përkasin fushës së teknikave të mësimdhënies, duke i ndihmuar kështu pedagogët në përmirësimin e qasjeve të tyre kundrejt mësimdhënies. Nëse edhe pas ndihmës së ofruar, performanca e pedagogut vazhdon të jetë e ulët, kontrata e tij zgjidhet. **[M1; M3] [Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.5 Ngritja e Këshillit të Profesorëve (që do të zëvendësohet nga Bordi i Profesorëve) i jep mundësinë universitetit të ngrejë në detyrë personelin e tij dhe t'i japë tituj shkencorë si "Profesor i Asociuar" dhe "Docent". Gjatë vitit të fundit akademik, 21 pedagogë morën titullin "Profesor i Asociuar", ndërsa 38 të tjerë morën titullin "Docent". **[2.4; 2.10; 2.1] [Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.6 Universiteti organizon edhe veprimtari sociale, si p.sh një sërë veprimtarish sportive në klubet sportive dhe veprimtari teatrale me profesionistë. Si shembuj më specifikë mund të

përmendim konkursin e poezive të krijuara nga studentët e universitetit, ndeshjet e futbollit midis universiteteve, dhe Këshillin Studentor të Universitetit të Gjirokastrës. [B5; M4][Kapitulli III Standardi IV.4]

- 2.7 Administrimi i burimeve njerëzore është efikas. [1.1; M3; M4; M11; Pyetësi i Personelit] Shumica e personelit shprehen se mbështetja e universitetit për personelin është e mirë ose shumë e mirë. [Pyetësi i Personelit] Pedagogët e rinj udhëhiqen nga pedagogët më me përvojë. [M2] Profesorët e huaj integrohen përmes projekteve të bashkëpunimit në universitetet e tjera. [M3] Personelit me më pak përvojë i ofrohet ndihmë në mësimdhënie dhe në veprimtaritë kërkimore përmes punës me kolegët më me përvojë. Megjithatë, kjo gjë mund të sjellë përforcimin e disa metodave të caktuara të mësimdhënies dhe kufizimin e larmisë së teknikave. Studentët dhe disa anëtarë personeli u shprehen se përdorimi i teknologjisë së informacionit gjatë mësimit është tejet i kufizuar, dhe duke qenë se i përkasin një brezi që e përdorin teknologjinë në masë, do të donin të zinte më shumë hapësirë në mësimdhënie. [M4; M5; M10] Leksionet e hapura si p.sh leksionet dhe seminarat publike mund të shërbejnë, në rastin më të mirë, si dritare për pasurimin e larmisë së teknikave të mësimdhënies, pasi mbahen nga anëtarët me përvojë të personelit ose nga personeli i universiteteve të tjera, duke përfshirë edhe ato ndërkombëtare, si p.sh nga Suedia. Zakonisht, leksionet e hapura përqendrohen rreth kërkimit ose punimeve të tjera, që mund të përfshijnë edhe pedagogjinë. [C2; M3] Anëtarët e rinj të personelit, përpara se të fillojnë të japin leksione, përfshihen nëpër seminare apo ushtrime. [M4; M5; M10] Megjithatë, përdorimi i teknikave të reja nuk është përkthyer ende në përfshirjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. [Kapitulli III, Standardi II.2]
- 2.8 Burimet financiare përdoren në përputhje me rregullat dhe standardet e institucioneve publike të arsimit të lartë. [1.6] Departamentet hartojnë propozimet e tyre për buxhetin, të cilat ia dorëzojnë fakultetit, Rektoratit dhe më pas Senatit Akademik për miratim, dhe së fundi Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar përpara se t'i dorëzohet Ministrisë së Arsimit. [2.12; 2.13] Për interesin e të gjitha palëve, organizohen diskutime, por pavarësisht kësaj, jo të gjitha nevojat arrijnë të plotësohen. [M3; M11] Shumica e personelit mendojnë se transparenca e alokimeve dhe përdorimi i buxhetit është i mirë ose shumë i mirë [B.6; B.7; B.8; Pyetësi i Stafit] [Kapitulli III Standardi VI.1]
- 2.9 Buxheti është i detajuar dhe universiteti ofron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare përmes Kancelarit dhe Drejtorisë së Financës brenda Rektoratit. [2.13; 2.14] Universiteti respekton rregullat dhe parimet bazë të administrimit të financave publike, siç përcaktohen në legjislacionin aktual. Universiteti i analizon treguesit rregullisht, duke e monitoruar zbatimin e politikës financiare përmes rishikimeve periodike të buxhetit dhe rishpërndarjes të fondeve sipas nevojës. [2.13; 2.14; B.5; B.6; B.7; B.8; Kapitulli III Standardi VI.2] Universiteti i nënshtrohet kontrolleve financiare nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Pas analizimit dhe diskutimit me strukturat përkatëse, raporti i veprimtarisë financiare diskutohet në mbledhjet e Senatit dhe publikohet në faqen e internetit. [B.6; B.7; B.8][Kapitulli III Standardi VI.3]
- 2.10 Universiteti ka bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për të rritur praninë online, megjithëse ky proces nuk është vënë ende plotësisht në zbatim. Orari mësimor, provimet, tarifrat dhe rregulloret mund të aksesohen online. Universiteti mbledh, analizon dhe përdor informacionet përkatëse për menaxhimin efikas të jetës akademike dhe veprimtarive të lidhura me të. Ai ka përforcuar sistemin Wi-Fi, i cili është tashmë i disponueshëm në të gjithë kampusin. [M2; M5; B.10][Kapitulli III Standardi VII.1]
- 2.11 Universiteti është vetëm në hapat e para të krijimit të një baze të dhënash të përgjithshme, e cila, si rrjedhojë, është e paplotë. Disa departamente kanë bazë të dhënash edhe për studentët e mëparshëm. Qendra e Alumni po mbledh informacion për ish-studentët, edhe pse nuk është ende gjithëpërfshirës apo i analizuar. Megjithatë, universiteti ka krijuar marrëdhënie të ngushta me Universitetin e Janinës, me të cilin pret të ndajë edhe përfundimet e informacionit të bazës së të dhënave. [M4] [Kapitulli III Standardi VII.1]
- 2.12 Nëpër auditorë, teknologjia e informacionit përdoret disi. Shumica e studentëve mendojnë se pajisjet kompjuterike janë në gjendje të mirë dhe se aksesin në sistemin elektronik është i

mirë ose shumë i mirë. **[Pyetësi i Studentëve]** Tre prej auditorëve kanë pajisje të posaçme për mësimdhënien e teknikave standarde të teknologjisë së informacionit. **[M5; M10]** Studentët kanë llogari personale, për të pasur akses në fushat përkatëse, si dhe adresa emaili. Studentëve iu ofrohet Wi-Fi tërësisht falas. Kjo gjë ka përmirësuar komunikimin me studentë, që tashmë mund të komunikojnë në mënyrë individuale ose në grup, kur kanë nevojë për këshillim rreth një çështjeje të caktuar ose për të marrë materialet e leksionit. **[M2; M5]** Të gjithë pedagogët kanë kompjuterët e tyre.

- 2.13 Disa auditorë kanë edhe video projektorë. **[M3; M10]** Një prej avantazheve është akses në internet për arsye akademike dhe telekonferenca, që ofron edhe adresat e shoqatave të matematikës dhe shkencës, të cilat e mbështesin punën e personelit dhe studentëve përmes periodikëve dhe teksteve **[M3; M12]** Aplikacionet e fizikës i japin mundësinë studentëve të vërejnë disa eksperimente. **[M14]** Universiteti pranon nevojën për një teknologji më të mirë informacioni për ndërmarrjen e kërkimeve. Ai ka mundësuar aksesin në punime akademike dhe ka përmirësuar komunikimin me kolegët në shkallë ndërkombëtare. Megjithatë, mungesa e përdorimit të teknologjisë së informacionit, që kufizon larinë e qasjeve të mësimdhënies, konsiderohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i **rekomandon** universitetit të ndërmarrë hapa për ta bërë përdorimin e teknologjisë së informacionit pjesë të ofrimit të programeve. Në disa fusha punohet përditë me teknologjinë e informacionit, si p.sh Përgjegjësi i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, që merret me ruajtjen e marrëdhënieve me vendet e Ballkanit, Holandën dhe Italinë **[M14; M15]****[Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.14 Universiteti ka një regjistër të saktë të pronave dhe asetëve nën përgjegjësinë e tij. Universiteti ka dokumente për pronat e paluajtshme, një inventar fizik të godinave, ku përfshihen edhe informacione për projektet dhe planet në funksion të çdo ambienti. Drejtuesit e mbikëqyrin ndërtimin përmes specialistëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar. **[2.16]** Universiteti i administron asetet me efikasitet dhe ka hartuar një masterplan për zhvillimin në të ardhmen. **[2.17]** Gjithashtu, universiteti po planifikon të rinovojë godinat ekzistuese, që aktualisht nuk janë në përdorim, megjithëse për këtë gjë nuk është rënë dakord në shkallë vendore dhe kombëtare dhe fondet e UNESCO-s nuk janë marrë ende. **[B.9; B.10; M3]****[Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.15 Universiteti ofron programin e Masterit të Shkencave në Arkeologji dhe Doktoraturë në Studime Albanologjike, të cilat ndihmojnë që të dyja në mbështetjen dhe përmirësimin e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. Krahas kësaj, organizohen edhe mbrëmjet e poezisë, që ndihmojnë në mbajtjen gjallë të poezive tradicionale. **[1.14]** Biblioteka e specializuar në qytetërimin ballkanik, e cila përmban edhe tekste shkollore në gjuhën greke apo fjalorë bashkëkohorë në gjuhën greke dhe shqipe, që i shërbejnë interesave të pakicës greke, është e hapur për mbarë komunitetin. **[M10]** Personeli dhe studentët, iu ofrohet edhe akses në arkivën kombëtare të Tiranës, dhe në atë të Athinës për Historinë e Shqipërisë. **[M14]** **[Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.16 Aktualisht, përdoren tre godina, por po planifikohet rikonstruktimi i një godine tjetër për ta vënë në dispozicion të universitetit. Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje me organizata të tjera sportive për ofrimin e veprimtarive sportive si p.sh me stadiumin dhe klubet sportive vendore. Spitali përdoret për t'i vendosur studentët e infermierisë në kushtet reale të punës. **[M2; M5]** Në përgjithësi, auditorët i përmbushin standardet. Megjithëse është e vogël, biblioteka ka një katalog online. Biblioteka ka teknologji informacioni, por nevojitet të zhvillohet më tej për t'i ofruar studentëve më tepër akses në këtë fushë. **[M10]** Partnerët e universitetit janë tejet mbështetës, dhe fondet e mbledhura nga disa projekte kanë mundësuar shtimin e pajisjeve të universitetit si p.sh të stereo-mikroskopëve me kamera të integruar dhe të pajisjeve për monitorimin e frekuencave të telefonave celularë. **[B.9; B.10; M12]****[Kapitulli III Standardi VII.5]**
- 2.17 Universiteti ka edhe organigramën që tregon mënyrën se si lidhen elementët e ndryshme të organizatës me njëri-tjetrin, dhe se si përfshihen të gjitha aspektet e punës së universitetit. Pavarësisht mbledhjes së informacioneve nga alumni, universiteti nuk i ka analizuar të dhënat, gjë që bie ndesh me praktikën e ndjekur nga e partnerët vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, edhe pse një analizë e tillë shërben si bazë për studimin e tregut të punës. **[2,19; M4; M1]****[Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.18 Në tërësi, ambientet, duke përfshirë edhe ambientet e përbashkëta, janë të përshtatshme për programet që ofron universiteti. **[2.16]** Tingujt, cilësia e ajrit dhe temperatura e mjedisit janë në nivelin e duhur, megjithëse më pak se gjysma e studentëve shprehen se auditorët mund të jenë shumë të ftohtë gjatë dimrit. **[2.20; pyetësi i studentëve; M5; M8]** Raporti hapësirë/student është në përputhje me legjislacionin, megjithëse universiteti po planifikon ta rrisë. **[Kapitulli III Standardi V.1]**

2.19 Universiteti i përmbush normat teknike duke përfshirë edhe mbrojtjen ndaj zjarrit, por nuk i përmbush kriteret e daljes së emergjencave për asnjë fakultet që ka mbi 200 studentë. Më pak se një e treta e studentëve mendojnë se ofrimi i ashensorëve dhe shkallëve të emergjencës është i mirë ose shumë i mirë dhe se **[Pyetësi i studentëve; M5; M10]** studentëve me aftësi të kufizuara nuk iu ofrohet akses i duhur. **[Pyetësi i studentëve; M10]** Studentët i vlerësonin pozitivisht ambientet e bibliotekës dhe personelin. **[Pyetësi i studentëve; M5, M1]** **[Kapitulli III Standardi V.1]**

2.20 Veprimtaria akademike e studentëve përpunohet vazhdimisht në mënyrë elektronike. Sekretaritet mësimor të çdo fakulteti e përgatisin dhe e ruajnë katalogun dhe arkivën kryesore jo vetëm në shkallë fakulteti, por edhe në serverin qendror, për të parandaluar shkatërrimin e tyre në rast fatkeqësie. Regjistri për studentët është si në format të shtypur, ashtu edhe në format digjital, të cilat mbahen nga sekretaritet e departamenteve. Informacioni financiar ruhet në nivel qendror. Universiteti është anëtar i sistemit të Rrjetit Akademik Shqiptar. **[M2; M4; M1]** **[Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesën e përdorimit të teknologjisë së informacionit të teknologjisë, që kufizon larminë e gasjeve kundrejt mësimdhënies (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.2**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- marrjen e masave për ta bërë teknologjinë e informacionit pjesë të ofrimit të programeve të tij (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.2**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Për të përmbushur rolin e tij si një institucion i orientuar drejt nevojave për zhvillim të rajonit të Shqipërisë Jugore, universiteti ka përgatitur një larmi programesh të ciklit të parë dhe të dytë për arsimin parësor dhe dytësor, si dhe për programet e ciklit të parë në infermieri, për t'i përgatitur studentët për tregun e punës së kësaj zone. **[RVV fq.1; 1.14]** Universiteti e ka identifikuar formimin e mësuesve si prioritet të një rëndësie të veçantë. **[SER fq.1; 1.14]** Ai ofron programe të ciklit të parë në Gjuhë dhe Letërsi Greke për përgatitjen e mësuesve, që do t'i shërbejnë nevojave të pakicës greke në rajon. Këto veprimtari janë përforcuar përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi me Universitetin e Janinës. **[C.12.]** Për të përforcuar më tej kapacitetin e tij si një institucion rajonal i orientuar drejt profesionit, universiteti i ka shtrirë programet e studimit edhe në fusha të tjera si p.sh në atë të biznesit, dhe ka krijuar rishtas Fakultetin e Ekonomisë. **[M1]** Hartimi i programeve, ku nevojat rajonale përfshihen në misionin e tretë të universitetit (për ndikimin dhe angazhimin në shoqëri) është i hollësishëm dhe përbën karakteristikë të **praktikës së mirë**, gjë që u pohua edhe nga palët e jashtme të interesit, të cilët kishin punësuar të diplomuarit e universitetit. **[M8] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.2 Programet e universitetit ndahen sipas parimeve të Procesit të Bolonjës në cikle të para, të dyta dhe të treta, ndërsa vetë programet e ciklit të dytë ndahen në "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave". **[3.1]** Së fundmi, është hapur edhe një program doktoreture i ciklit të tretë në Albanologji, megjithëse studentët nuk janë regjistruar ende. **[RVV fq.26]** Për hartimin e programit, universiteti do të ndihmohet nga ekspertët e Universitetit të Tiranës dhe të Qendrës së Studimeve Albanologjike në po të njëjtin qytet. **[M1]**
- 3.3 Programet e studimit hartohen fillimisht në shkallë departamenti. Më pas, projektprogramet i dërgohen Zyrës së Kurrikulave dhe Koordinimit të Trajnimeve brenda Rektoratit për të siguruar përputhshmërinë me udhëzimet përkatëse. Më pas, projekti i dërgohet Këshillit të Fakultetit për miratim, dhe së fundi Senatit. **[RVV fq.27; M4]** Palëve të interesit brenda dhe jashtë universitetit, duke përfshirë edhe studentëve, iu jepet mundësia e dhënies së sugjerimeve të tyre rreth hartimit dhe rishikimit të programit. **[M5; M8; B.4]** Përmes kësaj procedure të shëndoshë, arrihet objektivi i garantimit të mirë-hartimit dhe përshtatshmërisë së programit me qëllimin. Edhe ndryshimet e programit kryhen në mënyrë të ngjashme. **[C3, shembull i procedurës] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.4 Informacionet rreth programeve, të ofruara nga universiteti shpërndahen gjerësisht përmes faqes së internetit dhe medias së shtypur vendore, ndërsa për të depërtuar te audiencia e synuar janë përdorur barkodet dydimensionale. **[M2]** Për t'i paraqitur maturantëve ofertën e universitetit, organizohen ditë të hapura. **[2.6; M2]** Studentët nga Shqipëria dhe më gjerë, duke përfshirë edhe studentët nga fshatrat e banuara nga pakica greke ku flitet greqisht, u shprehën se, përpara se të aplikonin, ishin informuar plotësisht rreth ofertës së universitetit. **[M5]** Shpërndarja e informacionit përbën karakteristikë të **praktikës së mirë** dhe është tejet efikase për sa i përket mirinformimit të audiencës së synuar. Të gjithë ata maturantë, që e kanë përfunduar me sukses vitin e tretë, janë të përshtatshëm për të aplikuar në programet e ciklit të parë. **[1.1 Neni 16]** Studentëve ndërkombëtarë iu jepet e drejta për aplikim në kontekstin e marrëveshjeve dypalëshe. Çdo fakultet vendos dhe publikon në faqen e internetit kriteret e pranimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë, të cilat përcaktojnë mënyrën e hartimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë, për të siguruar bashkërendimin e programeve të studimit. **[1.1 Neni 17] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.5 Aktualisht, pavarësisht përfshirjes së dispozitave të përgjithshme në statut dhe rregullore, nuk ka asnjë politikë mbarë universitare për arsimin në vazhdim. **[1.2 Nenet 2.2, 2.7; 1.1 Neni 18]** Disa departamente dhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Arsim ofrojnë kurse për përmirësimin e zhvillimit profesional të mësuesve të rajonit, qoftë në Gjirokastër apo në zonat përreth. **[RVV fq.27; C.1 fq.11-12]** Më parë, universiteti ofronte edhe programe me kohë të pjesshme për kualifikimet e ciklit të parë dhe të dytë. Pavarësisht ndërprerjes së ofrimit të tyre me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, programet aktuale po zhvillohen ende sipas planit deri në përfundim, por pa pranuar studentë të rinj. **[RVV fq.27] [Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.6 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit përcakton kriteret për larinë e programeve akademike që do të ofrohen, si dhe kërkesat për arritjen e kualifikimeve për studentët. **[C1]** Programet e

studimit të ofruara nga universiteti përfshijnë programe që mbulojnë dy disiplina, si për shembull Histori dhe Gjeografi, si dhe programe një lëndore, që synojnë formimin e mësuesve. **[3.1]** Një prej zhvillimeve më të fundit është futja e programeve ku ndërthuret një disiplinë me një gjuhë evropiane si p.sh me gjuhën italiane. Universiteti po përgatit një program të përbashkët me Universitetin e Maceratës në Itali në fushën e Administrimit të Pasurive të Trashëgimisë Kulturore. **[3.2]** Kur është e përshtatshme, programet që synojnë përgatitjen e mësuesve të formuar apo të profesionistëve të shëndetit, përfshijnë edhe praktikë profesionale. **[2.20]** Në fund të programit të studimit, studentit i jepet suplementi i diplomës, ku ofrohen informacione të përgjithshme rreth programit në formën e krediteve e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), kurseve individuale dhe notave. **[3.12]** **[Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.4]**

- 3.7 Ngarkesa mësimore e stafit akademik përcaktohet sipas rregullave të drejtimit, të cilat i kërkojnë stafit me kohë të plotë të japin 260 orë mësimi në vit. Orët shtesë të mësimdhënies zhvillohen sipas marrëveshjeve në shkallë departamenti dhe financohen nga buxheti. **[RVV fq.28-9]** Çdo anëtar i stafit akademik i kërkohet të bjerë dakord me shkrim për angazhimet e tij akademike vjetore si në mësimdhënie, ashtu edhe në kërkim me Përgjegjës të Departamentit. **[3.3]** **[Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.8 Menjëherë pas regjistrimit, studentit i ofrohet informacion i plotë lidhur me programet e studimit përmes këndit informues të kampusit dhe faqes së internetit. Nëse kanë nevojë për ndihmë, ata i drejtohen personelit të sekretarive të fakulteteve. **[M11]** Në fillim të çdo kursi, studentët njihen edhe me kurrikulën dhe syllabuset përmes mësuesve të tyre. **[M5]** Gjithashtu, vihen në dispozicion specifikime të hollësishme, që përcaktojnë objektivat e programeve të studimit. **[3.4; 4.1]** **[Kapitulli I Standardi I.6]**
- 3.9 Programet e ciklit të parë përfshijnë shprehje të përgjithshme në fushën e metodave dhe parimeve shkencore, teknologjisë së informacionit dhe të gjuhës së huaj, si dhe shprehje lidhur me fushën e kualifikimit. Programet janë hartuar duke synuar kryesisht punësueshmërinë e studentëve menjëherë pas diplomimit. Faktet e ofruara nga punëdhënësit gjatë vizitës treguan qartë se ky qëllim është arritur. **[M8]** Gjithashtu, programet janë hartuar në mënyrë të tillë që ta bëjnë kalimin në ciklin e dytë sa më të lehtë në këtë universitet, ose gjetkë, nëse programet e ciklit të dytë nuk ofrohen nga universiteti në fjalë. **[RVV fq.30]** **[Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.10 Universiteti i mbështet studentët e vitit të parë në disa mënyra. Një ndër to është ofrimi i ndihmës financiare sipas meritës, në përputhje me politikën e drejtimit. **[RVV fq.31]** Studentëve iu ofrohen shërbime të këshillimit të karrierës në marrëveshje me organet e jashtme, si dhe vetë universiteti ka ngritur Qendrën e Këshillimit dhe Informimit Studentor. Për mbështetjen e studentëve dhe ngritjen e shqetësimeve lidhur me mirëqenien e tyre brenda organeve drejtuese të universitetit është krijuar pozicioni i Dekanit të Studentëve. **[RVV fq.31]** Megjithatë, në këtë detyrë nuk është caktuar ende asnjë person.
- 3.11 Si anëtarët e personelit, ashtu edhe studentët janë shprehur se metodat e mësimdhënies janë tejet tradicionale. **[M5;M11]** Disa pedagogë angazhohen në mënyrë të posaçme në pedagogji më ndërvepruese. **[RVV fq .31]** Leksionet e hapura të organizuara nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, ku përfshihen edhe prezantime nga ekspertë ndërkombëtarë, janë vënë në dispozicion edhe të kolegëve të fakulteteve të tjera të universitetit. **[M2]** Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare lehtëson edhe njohjen me zhvillimet pedagogjike në vende të ndryshme. **[M11]** Anëtarët e sapoemëruar të stafit akademik udhëhiqen nga kolegët me përvojë. **[M11]** Kjo udhëheqje është tejet e vlefshme, por mund të sjellë përforcimin e metodave tradicionale të mësimdhënies. Ky aspekt i punës së universitetit duhet rishikuar. **[Kapitulli I Standardi I.8]**
- 3.12 Për të lehtësuar mësimnxënien, studentëve iu është ofruar edhe akses në internet. Anëtarësimi i Departamentit të Matematikë Informatikës në shoqata ndërkombëtare, ka mundësuar aksesin online të studentëve në materiale shtesë. **[M12, M14]** Në fushën e infermierisë, shprehjet praktike të studentëve zhvillohen përmes marrëdhënies së ngushtë me spitalet vendore, ku studentët kryejnë edhe praktikën profesionale, si dhe përmes

pjesëmarrjes së studentëve në projekte, ku marrin pjesë shumë universitete të Ballkanit Perëndimor. [2.20; M14] **[Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.13 Në programet e ciklit të dytë, 92 për qind e mësimeve zhvillohet nga stafi akademik me kohë të plotë, shumica e të cilëve janë aktivë në kërkim. [RVV fq.32-3; 4.7; 4.8] Kërkimet shkencore të ndërmarra brenda universitetit janë në të mirë të programeve të Masterit të Shkencave. [RVV fq.32] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se, në disa fusha si të ciklit të parë, ashtu edhe të ciklit të dytë, disa studentë ishin angazhuar në mënyrë aktive në projektet kërkimore të Departamentit të Gjeografisë, dhe të Matematikë Fizikës. [M14] Këto projekte, të ndërmarra në fusha të ndryshme si p.sh. programimi i një aplikacioni celular për lehtësimin e turizmit në rajon, i dhanë mundësi studentëve të fitonin përvojë të drejtpërdrejtë në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të punës në terren. Ekipi e konsideron angazhimin e studentëve në kërkimin e ndërmarrë nga universiteti si karakteristikë të **praktikës së mirë**. Studentët e programeve të Masterit Profesional patën mundësi t'i kryenin praktikat profesionale në organizatat e përshtatshme profesionale, me të cilat universiteti ka lidhur edhe marrëveshje. [3.8] Puna e studentëve raportohet nga organizatat ku po kryejnë praktikën profesionale. [RVV fq.32] Në programet e Masterit Profesional në veçanti, ftohen në mënyrë të vazhdueshme pedagogë jashtë universitetit për të marrë pjesë në mësime. [RVV fq.33; 3.9] **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.14 Mobiliteti i studentëve në Evropë dhe më gjerë nxitet përmes mënyrave të ndryshme. Vetë programet e studimit janë hartuar sipas parimeve të Procesit të Bolonjës. Diplomat dhe suplementet e tyre, që lëshohen në gjuhën shqipe dhe angleze, ofrojnë informacionin e duhur rreth programit të studimit dhe krediteve ECTS. [RVV fq.33; 3.12] Programet e studimit hartohen në mënyrë të tillë që të përkohet sa më shumë të jetë e mundur me programet e ngjashme në vendet e ndryshme të Evropës. Në mbështetje të kërkesave të drejtimit, për të marrë diplomën, të gjithë studentët e ciklit të tretë duhet të japin një provim të gjuhës angleze apo të një gjuhe tjetër të huaj, të njohur në shkallë ndërkombëtare. [RVV fq.33] Universiteti ndjek një procedurë të caktuar për transferimin e krediteve nga universitetet e huaja, me të cilat ka lidhur marrëveshje pikërisht në këtë kuadër. Njohja e diplomave të studentëve të huaj i nënshtrohet miratimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. [RVV fq.33; 3.13] **[Kapitulli I Standardi I.10]**
- 3.15 Universiteti i strukturon programet e studimit në mënyrë të tillë që të ofrojnë veprimtari praktike dhe përvojë si në ciklet e para, ashtu edhe në ciklet e dyta. Një pjesë e konsiderueshme e programeve të shkencave të natyrës zhvillohen në laboratorë. [3.14] Për përgatitjen e tezave të diplomave në ciklin e dytë, studentëve iu ofrohet mbikëqyrja dhe udhëheqja e nevojshme. [4.3] **[Kapitulli 1 Standardi I.11]**
- 3.16 Në përgjithësi, universiteti përpiqet t'i hartojë programet e studimit në mënyrë të tillë që të përfaqësohen me nevojat e tregut të punës, [RVV fq. 26-7] si dhe t'i përditësojë për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e tregut të punës. Për të siguruar përshtatshmërinë e tyre, programet e reja rishikohen në shkallë fakulteti. Në këtë proces, merr pjesë edhe Zyra e Kurrikulave dhe Koordinimit të Trajnimeve në Rektorat. [1.1 Neni 6; M4] Programet e studimit përfshijnë edhe periudha të përshtatshme kohore për stazhe ose praktika profesionale, si dhe kurse që lidhen me punësimin, megjithëse nuk kryhen rregullisht. Në këtë drejtim, mungesa e të dhënave sistematike të punësimit përbën pengesë. [RVV fq. 35-6] Palët e interesit jashtë universitetit treguan gatishmërinë e këtij të fundit në marrjen parasysh të sugjerimeve rreth kurrikulës. [M8] **[Kapitulli I Standardi I.12]**

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- hartimin e programeve, ku nevojat rajonale përfshihen në misionin e tretë të universitetit (pika 3.1; **Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli 1 Standardi I.3**)
- shpërndarjen efikase e informacionit, që po siguron mirinformimin e audiencës së synuar (**pika 3.4; Kapitulli I Standardi I.1**)
- angazhimin e studentëve në mënyrë aktive në një sërë fushash si në ciklin e parë, ashtu edhe në ciklin e dytë në projektet kërkimore të Departamentit të Gjeografisë dhe Matematikë Fizikës (pika 3.13; **Kapitulli I Standardi I.9**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Universiteti e organizon në mënyrë efikase vënien në praktikë të programeve të tij të studimit. Në fund të çdo viti akademik, kryhen kontrolle në shkallë departamenti, në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit. **[1.1, Rregulloret; 1.2, Statuti i UGJ-së]** Hartimi i rregulloreve dhe dokumentimi i programeve të çdo departamenti dhe fakulteti, mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit përkatës dhe Përgjegjësi i Departamentit. **[4.1, Kopje të syllabuseve dhe programeve të studimit]** Universiteti kryen analizën vjetore të mësimdhënies dhe zbatimit të programeve në shkallë fakulteti dhe departamenti. Në fillim të çdo viti akademik, organizohen diskutime të hapura për të koordinuar zbatimin e duhur të kurrikulës. **[1.1, Rregulloret] [Kapitulli 1 Standardi II.]**
- 4.2 Universiteti garanton realizimin e formimit praktik dhe profesional të studentëve përmes punës dhe moduleve laboratorike, orëve praktike në ambientet e universitetit dhe praktikës së mbikëqyrur profesionale. Praktika e mësimdhënies nuk garantohet gjithmonë kur është e nevojshme dhe si rrjedhojë, fakultetet nuk kanë qenë gjithmonë në gjendje ta vlerësojnë performancën e studentëve gjatë praktikave të tyre të mësimdhënies jashtë universitetit. **[M11; M12]** Universiteti ka lidhur shumë marrëveshje bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore Rajonale në rrethe të ndryshme të vendit, me Qendrën Spitalore Omer Nishani, me institucione vendore si p.sh me bashkitë, këshillat bashkiakë, dhe me prefekturat, si dhe me institucione të tjera private si p.sh me bankën tregtare Raiffeisen Bank. **[M3; M4; 2.20 3.8; 4.2]** Universiteti bën të disponueshëm të gjithë literaturën dhe titujt e nevojshëm në bibliotekë, megjithëse materialet në disa fusha studimi nuk janë të përditësuara. **[Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.3 Universiteti ka rregulla dhe procedura të përcaktuara qartësisht për vlerësimin, të cilat miratohen nga strukturat përgjegjëse të universitetit dhe njihen mirë nga studentët dhe stafi akademik. Vlerësimi i punës së studentëve kryhet në shkallë departamenti dhe fakulteti brenda kuadrit të përgjithshëm. **[RVV fq.27]** Tetëdhjetë për qind e vlerësimit të një kursi bazohet në provimet me shkrim, të cilat jepen nën mbikëqyrjen e një komisioni prej dy pedagogësh. **[M13]** Universiteti i shpall rregulloret e provimeve përmes kanaleve të komunikimit të fakultetit dhe në faqen e tij të internetit **[<http://www.uogj.edu.al/uploads/file/RREGULLLORE%20E%20UGJ-.pdf>]** Fakultetet kanë rregullore të veçanta për provimet dhe vlerësimet, që mbështeten në rregulloret e universitetit. **[<http://www.uogj.edu.al/index.php?page=organet-drejtuese-te-universitetit>]** Universiteti ka miratuar edhe rregulla dhe procedura për diplomimin, për t'i pajisur studentët me dokumente zyrtare dhe të vlefshme nga pikëpamja ligjore. **[1.2; 1.1]** Gjatë vlerësimit të provimeve ruhet anonimiteti dhe fshehtësia. Pas vlerësimit me notë të provimeve, komisioni i provimit ka për detyrë t'ua komunikojë ato studentëve, sipas afateve të përcaktuara në rregullore. Ekziston edhe një procedurë përmes së cilës, studentët e pakënaqur me notën, të mund ta ankimojnë atë brenda 24 orësh, që nga shpallja e saj. **[M13]** Për të rishikuar këto raste, ngrihet një komision, në përputhje me rregulloret e fakultetit dhe programit. **[1.1; 1.9]** Studentët mund t'i shikojnë rezultatet e tyre vetjake të provimeve. Ata i njohin mirë procedurat e vlerësimit dhe u shprehën se janë të përshtatshme dhe të drejta. **[M5; M13; <http://www.uogj.edu.al/index.php?page=sherbime-online-student>]** **[Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.4 Programet e studimit rishikohen dhe përmirësohen vazhdimisht, pasi merren edhe sugjerimet e studentëve dhe punëdhënësve, si dhe përvoja e universiteteve të tjera. Programet dhe veprimtaria mësimore rishikohen dhe vlerësohen nga strukturat drejtuese. **[2.7; M5; M8]** Çdo anëtar i stafit akademik plotëson një raport vetëvlerësimi rreth veprimtarisë kërkimore, që dorëzohet dhe rishikohet çdo vit akademik. **[2.8; M14]** Studentët mund t'i shprehin mendimet e tyre rreth kurrikulës dhe stafit akademik përmes plotësimit të pyetësorëve, si dhe përfaqësimit në Këshillin Studentor. Studentëve nuk i bëhet e ditur në mënyrë sistematike se si merren në konsideratë dhe si përdoren opinionet e tyre. **[M3; M5; M6; M11; M12; M13]** **[Kapitulli I Standardi II.3; Kapitulli I Standardi II.4]**

- 4.5 Aktualisht, universiteti nuk ka një bazë të plotë të dhënash lidhur me punësimin e të diplomuarve. Megjithatë, ai përpiket t'i monitorojë të diplomuarit përmes komunikimit me ta dhe krijimit të bazës së të dhënave në shkallë departamenti. **[M2; M3; M4; M12; M13; M14]** Gjithashtu, veprimtaria e universitetit është e kufizuar lidhur me rritjen e vazhdueshme profesionale të të diplomuarve të tij. Duket se ky proces, është disi më i përparuar në Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. **[M11; M12] [Kapitulli I Standardi II.3]**
- 4.6 Universiteti ka ngritur edhe mekanizmat e mbështetjes për rrishtë në mësimdhënie si p.sh Zyrën e Kurrikulave dhe Koordinimit të Trajnimeve, misioni i të cilës është përmirësimi dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies në fakultet. **[M3; M4; M11; M12]** Universiteti mbështet përpjekjet e stafit akademik për rritjen e nivelit të kualifikimeve përmes studimeve të doktoraturës dhe formimeve të tjera. **[4.4; M1]** Për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, është miratuar ngritja e këshillit përkatës, me vendim të Senatit Akademik. Këshilli kryesohet nga Rektori dhe i raporton Senatit Akademik. Universiteti është përfshirë në disa projekte bashkëpunimi, të financuara nga Bashkimi Evropian, si për shembull përmes programit TEMPUS. Këto projekte përqendrohen te hartimi i programeve, ndarja e përvojës, si dhe te përmirësimi i kurrikulës dhe mësimdhënies. Universiteti nuk ruan informacion sistematik për mësuesit me performancë të ulët, megjithëse i ka të gjitha mekanizmat për mbështetjen e këtyre personave. **[M3; M4; M11; M12]** Për ta ndihmuar stafin akademik të njihet me qasje të ndryshme në mësimdhënie, realizohet shkëmbimi i anëtarëve të tij me universitete të ndryshme si me universitetin e Galicisë në Spanjë, Silesias në Poloni, Turkut në Finlandë, Patrës dhe Selanikut në Greqi, Nikosias në Qipro dhe të Halmstadit në Suedi. Shkëmbimet janë lehtësuar përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe projektit Erasmus+. **[1.13]** Kur nuk ka infrastrukturën e duhur për vënien në praktikë të programeve të studimit, universiteti përdor ambiente të tjera gjetkë. **[M3; M4; M5] [Kapitulli I Standardi II.4]**
- 4.7 Universiteti e konsideron numrin e lartë të anëtarëve të kualifikuar të stafit akademik (70 për qind e tij mbajnë tituj dhe grada shkencore) dhe larminë e fushave që ofron si pikë të fortë. Anëtarët e stafit që janë ende doktorantë, punojnë kryesisht me tema rajonale, në pajtim me zhvillimin strategjik të universitetit. **[M1; M3; M4]** Njësitë bazë të departamenteve ndahen sipas disiplinave të tyre të mësimdhënies, dhe kërkimi i tyre shkencor lidhet me fushat e tyre të ekspertizës së mësimdhënies. **[1.17; 1.14]** Ata nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë mësimdhënien, kërkimin dhe veprimtari të tjera akademike. Departamentet përqendrohen më tepër te mësimdhënia dhe bursat, sesa te kërkimi. Ata respektojnë lirinë akademike të stafit akademik dhe të drejtën e tyre të përdorimit të materialeve të disponueshme dhe burimeve financiare për programet e studimit. Mbështetja financiare për kërkimin shkencor është e pamjaftueshme. Përgjegjësia dhe kontrolli kërkimor kryhen më tepër në rrafsh individual, se sa në shkallë departamenti. **[M4; M10; M11] [Kapitulli II Standardi I.1]**
- 4.8 Universiteti mbështet grupet dhe projektet e reja kërkimore, si dhe mirëpret dhe nxit propozimet kërkimore, mbështetja e të cilave bazohet pjesërisht te burimet e miratuara financiare. **[4.6]** Ai bashkëpunon me institucione të tjera kërkimore, si publike, ashtu edhe private, kryesisht në fushën e mësimdhënies. **[1.13]** Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë kërkimore dhe të mësimdhënies lehtësohet përmes ndërveprimit me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. **[1.19; 1.20]** Fondet për mbështetjen e kërkimeve shkencore janë të kufizuara, ndërsa gjatë kohës së kryerjes së vizitës, universiteti ishte angazhuar vetëm në dy projekte, çka tregon se numri i projekteve ku universiteti përfshihet është i ulët. **[M11] [Kapitulli II Standardi I.2]**
- 4.9 Universiteti organizon konferenca shkencore, si dhe merr pjesë nëpër veprimtaritë e institucioneve të tjera, gjë që pasqyrohet vazhdimisht edhe në faqen e internetit. Çdo fakultet organizon konferenca në bashkëpunim me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, dhe gjatë pesë viteve të fundit, janë organizuar tre të tilla. **[4.7; <http://www.uogj.edu.al/index.php?page=njofitime-11>]** Universiteti mbështet kërkimin në fushën e shkencave të natyrës, shkencave të edukimit dhe shkencave shoqërore. Ai ofron hapësira laboratorike, megjithëse nuk janë gjithmonë të mjaftueshme, **[4.8]** si dhe ka nënshkruar disa marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. **[<http://www.uogj.edu.al/index.php?page=marredhenie-dy-paleshe>; 1.19; 1.20]** Universiteti organizon edhe ceremoni lidhur me arritjet kërkimore si p.sh. ceremoni për

dorëzimin e titujve akademikë, kërkimin në Albanologji, trashëgiminë kulturore apo mbrojtjen e mjedisit. [www.uogj.edu.al/index.php?page=njoftime-11;4.8] [Kapitulli II Standardi I.3]

- 4.10 Prioritetet kërkimore shkencore të universitetit përcaktohen nga departamentet dhe qendrat e kërkimit, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit. [1.14] Këto objektiva janë në përputhje me objektivat institucionale të universitetit, strategjitë rajonale dhe kombëtare të zhvillimit, si dhe me strategjinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Universiteti po planifikon ngritjen dhe vënien në punë të qendrave kërkimore brenda ambienteve të tij, dy prej të cilave janë tashmë në funksion. Buxheti i universitetit ofron fondin për mbështetjen e projekteve novatore. [M4; M11] Universiteti nxit diskutimet shkencore në fushat kryesore kërkimore, përmes organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura dhe seminareve, ku personeli angazhohet duke diskutuar rreth ideve dhe arritjeve shkencore. [M11] [Kapitulli II Standardi I.4]
- 4.11 Ndonëse prioritetet kërkimore shkencore të universitetit caktohen nga departamentet dhe qendrat kërkimore në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit, kësaj strategjie pesëvjeçare i mungon vizioni afatgjatë. [1.14] Universiteti nuk vë në dukje prioritetet e tij në krijimin e një profili specifik shkencor, në pajtim me programin e Strategjisë së Zhvillimit. Kjo mangësi lë vend për interpretime individuale lidhur me zbatueshmërisë së kërkimit në raport me strategjinë e zhvillimit. [M4; M11; M14] Disa prej fushave aktuale ku po përqendrohet veprimtaria kërkimore janë: mjedisi, trashëgimia kulturore, zhvillimi ekonomik rajonal, dhe kualifikimi i mësuesve. Bashkëpunimet tregojnë se universiteti ka krijuar marrëdhënie të ngushta me partnerë të rëndësishëm rajonalë në fusha të caktuara si në menaxhimin financiar të institucioneve të qeverisjes vendore, albanologji, kujdes shëndetësor apo arsimin profesional. [M8; M14; M15, M4] Në disa fusha, veprimtaria kërkimore e stafit është e hollësishme, e përshtatshme për rajonin, si dhe përfshin edhe studentë. Megjithatë, numri i përgjithshëm dhe angazhimi i anëtarëve të stafit në kërkime është i kufizuar, gjë që mund të ndikojë në kurrikul. [1.6; B7; M8; M14] Mungesa e qasjes strategjike për mbështetjen e kërkimit konsiderohet si **dobësi**. Grupi Vlerësimit të Jashtëm i **rekomandon** universitetit hartimin e një strategjie institucionale, ku të përcaktohen dhe mbështeten prioritetet. [Kapitulli II Standardi I.5]
- 4.12 Kërkimi lidhur me zhvillimin rajonal dhe ruajtjen e kulturës, i cili përcaktohet në aktet dhe dokumentet e tij kryesore, përbën një aspekt të rëndësishëm të veprimtarisë së universitetit. [1.14] Universiteti bashkëpunon në mënyrë të veçantë me Qendrën e Studimeve Albanologjike. Misioni i universitetit e vendos theksin te “nevoja për ndryshim dhe transformim, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve reale të shoqërisë, veçanërisht për të shërbyer si një qendër e rëndësishme kërkimore shkencore dhe botuese për Rajonin Jugor”. [hyrja e RVV-së] Universiteti bashkëpunon me qendrën e Studimeve Albanologjike në shkallë kombëtare në fushën e mësimdhënies dhe në disa projekte që përfshijnë organizimin e konferencave të përvitshme të përbashkëta. Midis bashkëpunësorëve ndërkombëtarë të universitetit renditen Universiteti i Palermos dhe Universiteti i Janinës në Greqi, me të cilin bashkëpunon në fushën e kërkimit për trashëgiminë e përbashkët arkeologjike të Greqisë së Veriut dhe Shqipërisë së Jugut, si dhe në fushën e trashëgimisë kulturore përmes gjuhës dhe letërsisë greke, që mbështetet nga botimi i fjalorit të parë voluminoz greqisht/shqip të ditëve të sotme dhe bibliotekës së specializuar të përmendur në pikën 2.15 [M8; M10] Bashkëpunimi në fushën e kërkimit në trashëgiminë kulturore përbën karakteristikë të **praktikës së mirë**. Kjo gjë, siç përmendet edhe në misionin e universitetit, ndikon pozitivisht në pakicën greke dhe Rajonin Jugor. [hyrja e RVV-së ; C12; M8; M10; M12; M13; M14] Midis bashkëpunësorëve të tjerë në shkallë kombëtare mund të përmendim Akademinë e Shkencave, Institutin e Kërkimeve Biologjike dhe Mjedisore si dhe universitete të tjera të Republikës së Shqipërisë. Universiteti nxit angazhimin e kërkuesve të rinj në veprimtari kërkimore, por do të donte të ofronte më shumë lehtësira dhe mbështetje për ta. [http://www.uogj.edu.al/index.php?page=njoftime-11; M11] [Kapitulli II Standardi I.6]
- 4.13 Universiteti ka bërë përpjekje për ndërkombëtarizimin e kërkimit të tij. Për këtë, janë organizuar shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe stafi akademik ka marrë pjesë në veprimtari të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit. Universiteti ka lehtësuar botimin e rezultateve të konferencave përmes periodikut të indeksuar “Kërkimi Universitar” [ISSN:2226-082X] <http://www.uogj.edu.al/index.php?page=seria-matematika-dhe-shkencat>

e-natyres] Megjithatë, ndërkombëtarizimi dhe publikimi i veprimtarive kërkimore të universitetit mbeten modeste, me vetëm gjashtë projekte në 11 vjet, që i përkasin të gjitha periudhës së para vitit 2004. **[1.13] [Kapitulli II Standardi I.7]**

4.14 Universiteti ndjek dhe analizon veprimtarinë shkencore të njësive dhe stafit të tij akademik, si dhe informohet vazhdimisht nga ky i fundit rreth veprimtarisë së tij shkencore. **[2.8]** Drejtimet madhore të kërkimit përcaktohen mbi bazën e temave kërkimore të doktorantëve të rinj. Për këtë qëllim, universiteti ka bashkëpunuar me universitete të tjera dhe me qendrat kërkimore brenda territorit të Shqipërisë. Universiteti i nxit kërkuesit e rinj të ndërmarrin nisma kërkimore dhe të angazhohen në projekte rajonale dhe kombëtare. Stafi akademik ka marrë pjesë në konferenca të organizuara nga universiteti dhe/ose partnerët e tij, të cilat janë ndjekur dhe nga doktorantë dhe partnerë vendorë. **[M12; M10]** Universiteti merret me punët e brendshme dhe të jashtme, si dhe merr në konsideratë faktorët ekonomikë dhe shoqërorë. Janë lidhur edhe marrëveshje me institucione publike dhe private. Shumica e praktikave profesionale dhe stazheve të studentëve zhvillohen në biznese të ndryshme të rajonit, për shembull në banka tregtare (Raiffeisen Bank), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, dhe Qendrën Spitalore Omer Nishani. **[2.20] [Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- puna bashkëpunuese në fushën e kërkimit në trashëgiminë kulturore (pika 4.12; **Kapitulli II Standardi I.6**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e qasjes strategjike për mbështetjen e kërkimit (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.5**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- hartimi i strategjisë institucionale nga universiteti, ku të identifikohen dhe mbështeten prioritetet (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.5**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Universiteti ndjek politikën e duhur për regjistrimin e studentëve të rinj. Studentët e ciklit të parë rekrutohen në përputhje me rregulloret e universitetit, në mënyra të ndryshme, duke përfshirë edhe takimet e drejtpërdrejta me maturantët, ditët e hapura, provimet e maturës shtetërore, ditët e informimit dhe faqen e tij të internetit. **[RVV fq.46; 2.7 (në gjuhën shqipe); faqja e internetit në 04/04/17 dhe 22/05/17; 1.1 Neni 16; 1.2 Neni 39; M2; M5]** Përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm është Qendra e Këshillimit të Karrierës. Për të informuar maturantët, universiteti komunikon vazhdimisht me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, si dhe ndjek procesin e vet të pranimit, siç përshkruhet me hollësi në rregulloren e tij **[1.1 Nenet 21 deri në 23]**, ndërsa rekrutimin e studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë ia beson pedagogëve të tij, në përputhje me rregulloret e universitetit dhe fakultetit. **[RVV fq.46; 1.1 Neni 17; 1.2 Neni 40]** Orientimi i studentëve ndërmerret nga vetë departamentet, dhe për këtë çështje nuk ka asnjë politikë të mirëfilltë universitare. **[RVV fq.46]** Universiteti ndjek “politika mirëpritjeje” për studentët e huaj, por nuk ka asnjë strukturë për rekrutimin e tyre, gjë që e njeh si dobësi, megjithëse aktualisht në këtë universitet po vazhdojnë studimet disa të tillë. **[RVV fq.46]** Universiteti publikon orarin e takimeve me studentët, të cilët fillimisht i drejtohen sekretarive, dhe vetëm më pas mund t’iu drejtohen anëtarëve të stafit me përvojë. Pedagogët, nuk kanë orar zyrtar për komunikimin me to. **[RVV fq.46-47]** Raporti i përgjithshëm pedagog-student i universitetit është 1:13, që është nën mesataren kombëtare, megjithëse në këtë raport nuk përfshihen orët laboratorike dhe programet e tjera. **[RVV fq.47; 5.1 (në gjuhën shqipe)] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 Universiteti komunikon dhe i informon studentët dhe stafin e tij akademik në mënyra të ndryshme, që përfshijnë këndet e informimit, emailin, faqen e internetit, dhe kur është e mundur, buletinin e kërkimeve universitare për komunikimin e jashtëm, si dhe sistemin online të bazës së të dhënave ESSE3 për komunikimin e brendshëm. **[RVV fq.47]** Të gjithë anëtarët e stafit akademik kanë adresa emaili. **[RVV fq.47]** Universiteti mban nga një dosje për çdo student, ku regjistrohen të dhënat e tyre përgjatë studimeve universitare që prej regjistrimit, duke përfshirë edhe të dhëna të tjera si p.sh notat. **[RVV fq.47; B.1; B.2; B.3]** Gjithashtu, universiteti ruan edhe të dhënat e kontaktit të të gjithë studentëve, duke përfshirë edhe adresën e vendbanimit, adresën e emailit dhe numrin e telefonit. **[RVV fq.47] [Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.3 Universiteti i informon, orienton dhe i udhëheq studentët e tij përmes Qendrës së Këshillimit dhe Informimit Studentor (QKIS), që ka Statutin e vet. **[RVV fq.47; 1.1 Nenet 27-28 (veçanërisht 4 për Statutin); M5; C5; C6; C11]** Studentët këshillohen dhe informohen edhe për programet e studimit apo orarin nga departamentet dhe pedagogët e tyre. **[RVV fq.47-48; M5]** Aktualisht, studentët nuk kanë tutorë personale dhe zakonisht i drejtohen Përgjegjës të Departamentit, por kjo situatë do të ndryshojë me krijimin e pozicionit të ri të Dekanit të Studentëve në të ardhmen. **[M5]** Megjithatë, studentëve të mësuesisë dhe infermierisë iu ofrohen mentorë. Në ciklin e dytë, një pedagog mund të marrë nën udhëheqje gjashtë studentë. **[M12]** Programet e studimit të universitetit zhvillohen në mënyrë progresive nga njohuritë e përgjithshme në vitin e parë, drejt punës me temë më specifike, duke përfshirë praktikat profesionale në vitet e fundit. **[RVV fq.48; M5]** Megjithëse në Raportin e Vetëvlerësimit raportohet gabimisht se “në institucionet e arsimit të lartë nuk lejohet ndryshimi i programit të studimit”, në Statutin e Universitetit shprehet qartësisht se ofrohet mundësia e transferimit të programeve, por nuk përcaktohen kriteret që duhen plotësuar në këtë drejtim. **[RVV fq.48; 1.2 Neni 43; M] [Kapitulli I Standardi III.3]**
- 5.4 Universiteti i mbështet studentët e kategorive të veçanta, si p.sh romët dhe egjiptianët e Ballkanit **[RVV fq.48; Vendimi Nr. 911 i Këshillit të Ministrave, datë 11.11.2015 (i ndryshuar)]** përmes përjashtimit nga pagesa e tarifës së shkollimit, si dhe duke përcaktuar kuota për pranimin e tyre, në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq.48]** Krahas kësaj, universiteti iu ofron studentëve të pakicës greke programin e studimit në Bachelor dhe Master në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, që konsiderohet si një prej pasurive të universitetit. **[RVV fq.48; 5.2 (në gjuhën shqipe); M3; M11: M13]** Universiteti i

mbështet studentët që merren me sport përmes ofrimit të sezoneve të provimeve dhe orëve shtesë. **[RVV fq.48]** Më parë, ai i mbështeste këta studentë përmes ofrimit të programeve të studimit me kohë të pjesshme, por një gjë e tillë nuk është më e mundur që prej vitit 2014-2015, me hyrjen në fuqi të ligjit përkatës. **[RVV fq.48; Neni 69 i Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë”,][Kapitulli I Standardi III.4]**

- 5.5 Universiteti ofron mbështetje dhe literaturë bazë për studentët, ku përfshihen një sërë tekstesh shkollorë cilësorë dhe literaturë shtesë për studimet e tyre. Studentët kanë akses në bibliotekën qendrore të universitetit dhe në dy biblioteka më të vogla të specializuara, që janë pjesë e Departamentit të Gjuhës Italiane dhe atij të Gjuhës Greke, të cilat përmbajnë tekste shkollorë, tekste të skanuara, baza të dhënash elektronike online dhe linqet e bibliotekave të tjera universitare kombëtare dhe ndërkombëtare. **[RVV fq. 48-49; 2.16; linku online i bibliotekës si në 03/04/17; M4; Turi i Bibliotekës]** Zyra e Standardeve dhe Kurrikulave krijon listën e literaturës të çdo kursi dhe programi. **[RVV fq. 48-49]** Gjatë viteve të fundit, shpenzimet për librat janë rritur nga 7,000 euro në vitin 2015 në 11,000 euro në vitin 2016, çka tregon se universiteti e pasuron vazhdimisht bibliotekën e tij. **[RVV fq.48-49; 5.3; Tui i Bibliotekës]** Një pjesë e buxhetit, i caktohet bibliotekës. **[RVV fq. 49; 4.6 zëri i faqes së fundit Libra për bibliotekën 2,000,000 (në gjuhën shqipe)]** Të gjithë studentët duhet të kenë një kartë regjistrimi për të pasur akses në literaturë, ndërsa në të ardhmen, universiteti po planifikon të vërë në përdorim kartat elektronike bibliotekare. Studentët u shprehën të kënaqur me titujt që universiteti iu vinte në dispozicion, si në format të shtypur ashtu edhe në format elektronik. **[RVV fq.49; M5; Turi i Bibliotekës] [Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.6 Universiteti mbështet edhe studentët e ciklit të parë. Gjatë orientimit, që monitorohet nga Zëvendës Rektori, stafi akademik i departamenteve i prezanton studentët me ato çka duhet të dinë me saktësi rreth universitetit dhe programeve të tij. **[M2; M5]** Stafi akademik ofron edhe udhëheqje gjatë përgatitjes së tezave, procedura të qarta për detyrat e kursit dhe udhëzime për literaturën përmes pedagogëve dhe departamenteve. **[RVV fq.49]** Megjithëse universiteti nuk ofron kurse për t'i ndihmuar studentët në vështirësi, në syllabuse parashikohen takime me pedagogët, të cilat zhvillohen edhe në mënyrë të paplanifikuar. **[RVV fq. 49][Kapitulli I Standardi III.6]**
- 5.7 Universiteti i nxit studentët të marrin pjesë në jetën universitare. Në muajin janar të çdo viti akademik, zgjidhen përfaqësuesit e studentëve nga çdo vit dhe disiplinë. Pas kësaj faze, ata zgjedhin tre senatorët e studentëve, duke përfshirë edhe Kryetarin e Këshillit Studentor. **[RVV fq.49; Neni 55 i Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë' dhe ndryshimet e tij]** Këshilli Studentor është një kanal komunikimi dydrejtimësh për studentët pasi i informon ata rreth aktiviteteve, si dhe mbledh informacion rreth atyre çka studentët duan, duke përfshirë edhe ankesat. **[M5]** Përfaqësuesit e Këshillit Studentor marrin pjesë në Senatin Akademik dhe në Këshillat e Fakultetit, ku parashatrojnë propozimet dhe idetë lidhur me, për shembull, syllabuset e lëndëve, programet e studimit dhe rregulloret. **[RVV fq.49-50; 5.4; M5]** Në Statutin e ri përshkruhen Këshillat Studentorë dhe pozicioni i Dekanit të Studentëve. Në të ardhmen, zgjedhjet për studentët që do të marrin pjesë në Senatin Akademik dhe Këshillat Studentorë të fakulteteve do të mbahen çdo dy vjet. **[Ligji Nr. 23, datë 21.04.2016; 1.1a (në gjuhën shqipe)]** Procesi aktual i përfaqësimit të studentëve nuk është plotësisht i qartë. Studentët i paraqesin propozimet e tyre përmes mbledhjeve studentore, Dekanit ose “kutisë së kërkesave”. Në Raportin e Vetëvlerësimit citohen dy shembuj të propozimeve studentore: ndryshimi i sezoneve të provimeve dhe rritja e numrit të praktikave profesionale pranë institucioneve profesionale. **[RVV fq.50]** Universiteti i ofron organizatave studentore mbështetje minimale financiare për shkak të kërkesave të shumta për buxhet. **[RVV fq.50; Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.8 Universiteti përpiqet të ofrojë veprimtari ekstra kurrikulare, por mbështetja që ofron është e paktë për shkak të kufizimeve buxhetore. Më parë, universiteti organizonte mbrëmje poetike, ndeshje futbolli dhe festa, por studentët përmendën edhe shembuj të tjerë si veprimtari sportive dhe teatrore, si dhe aktivitete sipërmarrjeje. Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, në universitet po jepej një shfaqje teatrore. Universiteti angazhohet vazhdimisht edhe me Kryqin e Kuq. **[RVV fq.50; B5.2; M5][Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Universiteti i ndihmon studentët të gjejnë punë përmes mënyrave të ndryshme si p.sh vendosjes në praktikë profesionale, workshop-eve si panairët e punës, dhe rrjetit të gjerë rajonal të kontakteve (shihni edhe pikën 1.11). **[RVV fq.50; 1.1; Neni 39]** Qendra e Këshillimit të Karrierës i kushtohet posaçërisht punësimit të studentëve në të ardhmen. Universiteti ofron edhe rekomandime në shkallë departamenti, si dhe punëson vetë disa prej studentëve të tij. **[RVV fq.50; 1.1 Neni 39]** Megjithatë, ai nuk ka asnjë bazë të dhënash për mbledhjen e të dhënave statistikore për punësimin e studentëve, megjithëse disa prej departamenteve kanë të tilla (shihni edhe pikën 1.10) **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë:

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e Tyre janë përmbushur kryesisht

Lista e Dokumenteve

A. Raporti i Vetëvlerësimit (RVV)(Aneksi 4, RVV)

Dokumentet, Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- [1.1] Rregullorja e Institucionit
- [1.1a] Rregullorja e re e Institucionit
- [1.2] Statuti i UGJ-së
- [1.2a] Statuti i ri i UGJ-së
- [1.3] Modalitetet dhe standardet e punësimit të stafit akademik
- [1.4] Rregullat dhe rregulloret e funksionimit të sistemit ESSE3
- [1.5] Vendimet e Senatit dhe Bordit të Administrimit për Buxhetin e vitit 2017
- [1.6] Buxheti i vitit 2017 <http://uniel.edu.al/index.php/al/drejtoria-ekonomike>
- [1.7] Vendimet e Bordit të Administrimit për legjislacionin e fundit
- [1.8] Rregullat dhe rregulloret e Këshillit të Etikës
- [1.9] Rregullat dhe rregulloret e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
- [1.10] Vendimi i Senatit për ngritjen e Këshillit të Profesorëve
- [1.11] Rregulloret e Senatit Akademik të UGJ-së
- [1.12] Vendimi për ngritjen e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë
- [1.13] Lista e projekteve ndërkombëtare, ku UGJ-ja është partnere
- [1.14] Strategjia e Zhvillimit të UGJ-së
- [1.15] Raporti Vjetor për veprimtarinë akademike dhe shkencore të UGJ-së
- [1.16] Raporti Vjetor për veprimtaritë akademike dhe shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
- [1.17] Struktura organizative e UGJ-së
- [1.18] Struktura e stafit akademik të UGJ-së
- [1.19] Lista e marrëveshjeve ndërinstitucionale për veprimtaritë praktike të studentëve midis UGJ-së dhe institucioneve të tjera
- [1.20] Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare

Dokumentet, Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- [2.1] Organograma e Universitetit të Gjirokastrës
- [2.2] Lista e stafit akademik me kohë të pjesshme
- [2.3] Modeli i shpalljes së vendeve të lira
- [2.4] Titujt akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Docent” të dhënë nga Këshilli i Profesorëve
- [2.5] Tabelë model e të gjithë treguesve për rekrutimin e pedagogëve
- [2.6] Raporti i ditëve të hapura
- [2.7] Analiza model vjetore e departamenteve
- [2.8] Grafiku i vlerësimit të punës së pedagogëve dhe arritjeve akademike
- [2.9] Lista e pedagogëve që kanë dhënë mësim në universitetet perëndimore
- [2.10] Lista e profesorëve të huaj që janë angazhuar në dhënien e titujve akademikë në UGJ
- [2.11] Kërkesa model me shkrim e një pedagogu që kërkon të marrë titullin akademik “Profesor” në një universitet tjetër
- [2.12] Raporti buxhetor i vitit 2016, dhe vendimi i Bordit të Administrimit
- [2.13] Propozimi i projektbuxhetit të fakultetit ose departamentit
- [2.14] Organograma e Drejtorisë Ekonomike
- [2.15] Urdhri për miratimin e programeve të transparencës
- [2.16] Lista e pronave të paluajtshme të universitetit
- [2.17] Lista e projekteve lidhur me restaurimin e ambienteve të UGJ-së
- [2.18] Lista e ambienteve të stafit akademik për çdo fakultet
- [2.19] Raport për pyetësorët
- [2.20] Lista e marrëveshjeve institucionale për kryerjen e praktikës profesionale

Dokumentet, Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- [3.1] Lista e programeve të studimit të ofruara nga UGJ-ja
- [3.2] Marrëveshje institucionale me Universitetin e Maceratës
- [3.3] Marrëveshje për caktimin e ngarkesës vjetore të stafit akademik të UGJ-së

- [3.4] Shembull i procedurave që ndiqen për hapjen dhe krijimin e programeve të studimit të ciklit të parë (Master i Shkencave në Gjuhësi), Master Profesional në Administrim Publik ose në programet e ciklit të parë (Bachelor në Gjuhën Angleze)
- [3.5] Statistika për realizimin e ngarkesës së mësimdhënies të stafit akademik me kohë të plotë të UGJ-së
- [3.6] Numri i pedagogëve me dhe pa tituj akademikë
- [3.7] Ekstrakt nga procedurat e hapjes së programit të studimit “Master i Shkencave në Mbrojtjen Mjedisore”
- [3.8] Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale
- [3.9] Lista e lektorëve të ftuar nga fusha e biznesit apo fusha të tjera
- [3.10] Model i çdo programi studimi, “Administrim Biznesi në Gjuhën Angleze”, “Master profesional në Turizëm” dhe Doktoratë në Albanologji
- [3.11] Plan model mësimor
- [3.12] Suplementi/shtojca e diplomës
- [3.13] Për shkëmbimin e studentëve nga dhe drejt UGJ-së
- [3.14] Programet e studimit që përfshijnë orë laboratorike dhe praktikë profesionale

Dokumentet, Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- [4.1] Kopje e syllabusit dhe programit të studimit për dy ciklet e studimit për çdo fakultet
- [4.2] Procedura e praktikës studentore
- [4.3] Udhëzues për përgatitjen e diplomës
- [4.4] Tabelë me të dhënat e kualifikimeve të stafit
- [4.5] Marrëveshje me Bashkinë e Gjirokastrës për fushat sportive
- [4.6] Dokument për hartimin e projektbuxhetit të UGJ-së
- [4.7] Informacion për konferencat e organizuara nga UGJ-ja
- [4.8] Informacion për botimet dhe konferencat ku ka marrë pjesë personeli
- [4.9] Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet kërkimore publike dhe private
- [4.10] Ditët akademike në UGJ

Dokumentet, Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- [5.1] – Statistika për raportin student/pedagog
- [5.2] – Modaliteti për hapjen e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek”
- [5.3]- Lista me pasurimin më të fundit të literaturës
- [5.4] – Vendimi i KIZ-it (Komisioni Institucional i Zgjedhjeve) për zgjedhjen e anëtarëve studentë të Senatit

B. Lista e dokumenteve shtesë (fazë e bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit)

- B.1. Regjistri i të dhënave akademike
- B.2 Regjistër elektronik
- B.3. Regjistri i studentëve
- B.4. Shembull i procedurave që ndiqen për përmirësimin e programeve me kohë të plotë
- B.5. Dokumentet e mëposhtme të dobishme për UGJ-në
- B.6. Raporti për projektbuxhetin e vitit 2017
- B.7. Raporti për projektbuxhetin e vitit 2016
- B.8. Propozimet e projektbuxhetit të departamenteve
- B.9. Lista e projekteve të pronave të paluajtshme
- B.10. Lista e hapësirave të mësimdhënies
- B.11. Raport për anketimet e studentëve
- B.12. Lista e marrëveshjeve për praktikën profesionale të studentëve

C. Lista e dokumenteve shtesë (vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm)

- C.1. Strategjia e Zhvillimit të UGJ-së (shqip-anglisht)
- C. 2. Raporti Vjetor i UGJ-së, 2016 (shqip- anglisht)
- C.3. Shembull i procedurave që ndiqen për përmirësimin e programeve me kohë të plotë, (shqip-anglisht)
- C.4 Diagrami i procedurave të zgjidhjes së problemeve akademike (anglisht)
- C.5. Termat e referencës së Qendrës së Këshillimit të Karrierës (shqip- anglisht)
- Plani i veprimtarisë mujore të Qendrës së Këshillimit të Karrierës (shqip- anglisht)
- C.6. Termat e referencës së Qendrës së Këshillimit të Karrierës, Plani i veprimtarisë mujore të Qendrës së Këshillimit të Karrierës (shqip)

- C.7. Baza e të dhënave të alumni, (shqip)
- C.8. Rregullorja e administratës dhe termat e referencës për çdo funksion administrativ, Neni 42, (shqip- anglisht)
- C.9. Raportet e projektit U3M, (anglisht)
- C.10. Raporti i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, 2014 (shqip-format i shtypur në IAL)
- C.11. Organograma e Universitetit 'Eqrem Çabej' (shqip- anglisht)
- C.12. Shembull bashkëpunimi me Universitetin e Janinës (anglisht)
- C.13. Axhenda e mbledhjeve me emrat e pjesëmarrësve sipas grupeve të paracaktuara (shqip-anglisht)

Shënimet gjatë mbledhjeve

- M1, Mbledhje 1 me Rektorin
- M2, Mbledhje 2 me Grupin e Vetëvlerësimit
- M3, Mbledhje 3 me Senatin Akademik (pa Rektorin)
- M4, Mbledhje 4 me Rektoratin (pa Rektorin)
- M5, Mbledhje 5 me studentët
- M8, Mbledhje 8 me partnerët e jashtëm dhe alumni
- M10, Turi në ambientet e universitetit
- M11, Mbledhje me 11 përgjegjësit e departamenteve dhe sekretarive administrative
- M12, Mbledhja 12 me profesorët dhe stafin me përvojë kërkimore
- M13, Mbledhje 13 me stafin akademik pa titullin "Profesor"
- M14, Mbledhje 14 me stafin pa përvojë kërkimore
- M15, Mbledhje 15 me Bordin e Administrimit dhe drejtuesit

Pyetësi i personelit

Pyetësi i studentëve